

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

(Të gjitha balancat janë në lekë).

Bazat e përgatitjes së Pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, sipas kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (formati SKK-2). Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar parimit të kostos historike duke u kombinuar me element të metodave të tjera dhe parimit të të drejtave të konstatuara. Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj në një të ardhme të parashikuar. Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale dhe e paraqitjes të pasqyrave financiare të Shoqërisë. Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon që drejtimi të kryejë gjyqime, vlerësime dhe përlogaritje, të cilat kanë efekte në aplikimin e politikave kontabel dhe në vlerat e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe përlogaritjet janë bazuar në përvojën e mëparshme dhe në faktorë të tjerë, të cilët drejtimi i shoqërisë i konsideron të arsyeshëm sipas rrethanave. Rezultatet e tyre përbëjnë bazën për vlerësimin e vlerës për t'u mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për të cilat nuk janë dhënë informacione shpjeguese në burime të tjera. Vlerësimet dhe gjyqimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Efektet që rrjedhin nga rishikimi i vlerësimeve kontabel njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është riparë dhe në çdo periudhë të ardhshme. Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabel neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

a- Paraqitja dhe vlerësimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale

Zërat e aktiveve afatgjata materiale, përveç tokës, paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen kostos së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor. Amortizimi i AAM-ve llogaritet sipas normave të miratuara me Ligjin 8438 datë 28/12/1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar. Norma e amortizimit për ndërtesat të trupëzuara në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme në ndërtesat ose tokën është 5% të vlerës së mbetur, makineri dhe pajisje pune të montuar në ndërtesë për një periudhë 20 vjeçare 5% të vlerës së mbetur, mjete transporti 20% të vlerës së mbetur, kompjuterat dhe sistemet software 25% të vlerës së mbetur, dhe AAM e tjera me 20% të vlerës së mbetur. Për AAJM norma e amortizimit është 15% të vlerës lineare të tyre. Kostot e blerjes ose ndërtimit, kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të ndërtesave, si dhe kostot e konstruksioneve, makinerive e pajisjeve me afat përdorimi më të madh se 20 vjet, të trupëzuara në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me ndërtesat ose tokën. Te tilla janë sendet e ngjitura me plumb, gips ose tjetër që nuk mund të shkeputen pa u thyer ose pa u cenuar, ose pa prishur apo demtuar pjesën e tokës ose të ndërtesës me të cilën është trupëzuar si p.sh. asensorët, konstruksionet metalike pjesë e ndërtesës, instalimet elektrike dhe hidraulike, etj. Po në këtë mënyrë amortizohen edhe impiantet e ndryshme të transportit si: ujësjellësit, naftësjellësit, gazsjellësit, linjat hekurudhore, linjat e tensionit të lartë, teleferikët, e të tjera aktive të ngjashme me to. Norma e amortizimit të këtyre aktiveve është 5 për qind mbi vlerën e mbetur. Në rastet kur vlera e mbetur e aktivit në fillim të periudhës tatimore është më e vogël se 3% e kostos historike të këtij aktivi, atëherë kjo vlerë e mbetur do të njihet tërësisht si shpenzim i zbritshëm në fund të kësaj periudhe tatimore. Kompjuterat, sistemet e informacionit, programet kompjuterike dhe në përgjithësi produktet software e pajisjet e ruajtjes së të dhënave. Norma e amortizimit për këtë kategori aktivesh është 25 për qind. Të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë të cilat nuk përfshihen më sipër, si makineritë e pajisjet e prodhimit e të shërbimit, mjetet e transportit të të gjitha llojeve, etj., amortizohen me një normë të lejuar për efekt fiskal prej 20%.

Lëvizja e AAM-ve dhe AAJM të shoqërisë për periudhën ushtrimore paraqiten në tabelën si më poshtë:

Aktive Afatgjata Materiale me vlerë fillestare						
Nr	Emertimi	Gjendje fillim	Sh. Rivlerësimi	Shtesa	Pakesime	Gjendje fund
1	Toka	0	0	0	0	0
2	Ndertime	0	0	0	0	0
3	Makineri, pajisje	0	0	2,500,000	0	2,500,000
4	Mjete transporti	0	0	1,133,100	0	1,133,100
5	Pajisje kompjuterike	0	0	159,315	0	159,315
6	Inventar ekonomik	0	0	3,952,030	0	3,952,030
7	Te tjera AAM	0	0	0	0	0
	Totali	0	0	7,744,445	0	7,744,445
Amortizimi A.A Materiale						
Nr	Emertimi	Gj. akumuluar	Sh rivlerësimi	Amortizimi vitit	Pakesime	Gjendje mbartur
1	Toka	0	0	0	0	0
2	Ndertime	0	0	0	0	0
3	Makineri pune	0	0	416,667	0	416,667
4	Mjete transporti	0	0	20,833	0	20,833
5	Pajisje kompjuterike	0	0	16,796	0	16,796
6	Inventar ekonomik	0	0	399,319	0	399,319
7	Te tjera AAM	0	0	0	0	0
	Totali	0	0	853,615	0	853,615
Vlera Kontabel Neto e A.A Materiale						
Nr	Emertimi	VI kont neto fillim	Sh rivlerësimi	Shtesa	Pakesime	VI kont neto fund
1	Toka	0	0	0	0	0
2	Ndertime	0	0	0	0	0
3	Makineri pune	0	0	2,500,000	416,667	2,083,333
4	Mjete transporti	0	0	1,133,100	20,833	1,112,267
5	Pajisje kompjuterike	0	0	159,315	16,796	142,519
6	Inventar ekonomik	0	0	3,952,030	399,319	3,552,711
7	Te tjera AAM	0	0	0	0	0
	Totali	0	0	7,744,445	853,615	6,890,830

6,890,830

b- Paraqitja dhe vlerësimi i mjeteve monetare

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj,

Gjendja e mjeteve monetare në fund të periudhës ushtrimore paraqitet në pasyren e mëposhtme:

Nr.	Emertimi bankes	Nr llogarise	Monedha	Vlera	Kursi këmbimit	Vlera totale
1	Raiffeisen Bank		Leke	259,146.00	1.00	259,145
2	Raiffeisen Bank		Euro	59.00	114.23	6,740
3	Credins		Leke	67,355.00	1.00	67,355
4	Credins		Euro	22,180.50	114.23	2,533,679
5						0
6						0
7						0
8						0
	Totali					2,866,918

c- Paraqitja dhe vlerësimi i shpenzimeve ushtrimore

Shpenzimet e njësise ekonomike të vitit financiar përfaqësojnë shpenzimet e blerjes të mallrave, lendeve të para dhe të shërbimeve të konsumuara për veprimtarinë përcore, koston e shërbimeve kryesore të vlerësuar me çmimin e blerjes dhe të vertetuar me fatura origjinale e dokumenta të tjera kontable, shpenzimet që lidhen në mënyrë direkte me mallrat ose produktet të destinuar për shitje. Pagat shpërblimet dhe kompesimet monetare, sigurimet shoqërore të paguar nga njësia ekonomike të llogaritur mbi pagën që i përketin periudhës kontable pavarësisht nga fakti nëse ato janë paguar ose jo. Shpenzime të amortizimit që vijnë nga renia në vlerë e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale. Shpenzime të tjera të pa përfshirë në zërat e mësipërm por që lidhen me veprimtarinë kryesore të njësise ekonomike.

Blerjet e kryera gjatë vitit ushtrimit paraqiten si më poshtë:

Nr	Emertimi	Vlefte
1	Ndertese	-
2	AAM M.Pajisje Pune	2,500,000
3	AAM Mjete Transporti	1,133,100
4	AAM Inv Ekonomik	3,952,030
5	AAM Pajisje Informatike	159,315
6	Materiale Pune te tjera	452,955
7	Blerje Mallra	14,328,790
8	Blerje Materiale	3,624,567
9	Bleje Shërbime	-
10	Blerje Karburant	4,355,050
11	Mirembajtje Riparime	4,054,910
12	Siguracione	81,511
13	Te tjera per dekorin e plazhit	6,363,943
14	Taksa dhe tarifa	16,385
15	Blerje poste,telefon,internet	28,665
16	Shpenzime juridike dhe kontabiliteti	354,441
	Totali	41,405,662
	Deklaruar ne FDP	41,405,662
	Diferenca e deklarimit	0

Shpenzimet që i përketin vitit ushtrimit paraqiten si më poshtë:

Nr	Emertimi	Vlefte
1	Blerjet gjate vitit ushtrimit	14,328,790
2	Gjendja e mallrave ne fillim te vitit	388,390
3	Gjendja e mallrave ne fund te vitit	-
4	Blerje Materiale	3,624,567
5	Materiale Pune te tjera	452,955
6	Blerje Karburant	4,355,050
7	Mirembajtje Riparime	4,054,910
8	Siguracione	81,511
9	Te tjera per dekorin e plazhit	6,363,943
10	Taksa dhe tarifa	16,385
11	Blerje poste,telefon,internet	28,665
12	Shpenzime juridike dhe kontabiliteti	354,441
13	Paga	8,338,269
14	Sigurimet shoqërore	1,392,491
15	Amortizimi i AAM-ve	853,615
16	Shërbime bankare	64,736
17	Shpenzimi humbje nga konvertimi	253,834
18	Totali	44,952,552
19	Shpenzime te perjashtuar per efekte fiskale	0
	Totali	44,952,552

d- Paraqitja dhe vlerësimi i të ardhurave ushtrimore

2	te ardhura nga aktiviteti bar restoran plazh	46,617,775
3	te ardhura nga aktiviteti dytesor 2	0
4	te ardhura nga aktiviteti dytesor 3	0
5	Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	0
6	Totali	72,315,660
7	Deklaruar ne FDP	72,315,660
8	Diferenca e deklarimit	0

Të ardhura e tjera :

Nr	Emertimi	Vlefte
1	Te ardhura nga ndryshimi në inventarin e produktit dhe prodhimit në proces	0
2	Kliente per pagesat parardhnie sipas prenotimit paraprak	0
3	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	0
4	Totali	0
5	Deklaruar ne FDP	0
6	Diferenca e deklarimit	0

Te ardhura te tjera financiare

Nr	Emertimi	Vlefte
1		0
2		0
3		0

e- Paraqitja dhe vlerësimi i tatimit mbi fitimin ushtrimor (deklarata vjetore e ardhurave dhe shpenzimeve)

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin vlerësohet në bazë të rezulttit të periudhës financiare, tatimi mbi fitimin llogaritet sipas rregullave që janë parashikuar në ligjin e tatimit mbi të ardhurat në

Nr	Emertimi	Vlefte
1	Te ardhura totale nga shitja	72,315,660
2	Shpenzimet totale te ushtrimit	44,952,552
3	Shpenzimet e panjohura	0
4	Fitimi ushtrimor (+) Humbje (-)	27,363,108
5	Norma e tatimit mbi fitimin	15%
6	Tatimi mbi fitimin ushtrimor	4,104,466
7	Tatimi fitimi i shtyre	0
8	Pagesa parardhnie e kesteve te tatim mbi fitimin	15
9	Tatimi mbi fitimin per te paguar/ i paguar me teper	4,104,451
10	Fitimi neto	23,258,642

e- Të dhënat të tjera për shoqërinë

Në referim të nenit 16 të ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" në këtë aneks të shënimeve shpjeguese po paraqesim: numrin mesatar te punonjësve gjatë

Nr	Emertimi	Vlera
1	Nr mesatar i punonjesve te njesise ekonomike gjate periudhes raportuese	17
2	Shuma vjetore e pages se organeve drejtuese te njesise ekonomike	0
3	Shuma vjetore e pages se organeve mbikqyrese e te njesise ekonomike	0
4	Emeri dhe selia e njesise ekonomike ne te cilen njesia zotron nje interes me pjesemarrje	nuk ka
5	% e kapitali te zotuar ne interesin me pjesemarrje	0

Organizimi i kontabilitetit të shoqërisë

Kontabiliteti i shoqërisë është ndërtuar në përputhje me kërkesat e paeashikuar në ligjin nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Administratori i Shoqërisë

Devid Patrut